



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E INSPEKTIMIT DHE MBIKËQYRJES

Nr. 407/10 Prot.

Tiranë, më 19.09.2025

Lënda: Dërgohet Vendimi i Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, “Për përfundimin e procesit të verifikimit të ekzekutimit të vendimit të Komisionerit nr. 12, datë 11.04.2025”

BASHKISË PËRMET

Në përfundim të procesit të verifikimit, Ju dërgojmë Vendimin e Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, “Për përfundimin e procesit të verifikimit të ekzekutimit të vendimit të Komisionerit nr. 12, datë 11.04.2025”.

Bashkëlidhur me këtë shkresë dhe vendimi përkatës.

Duke Ju falënderuar për bashkëpunimin,

KOMISIONERI

Pranvera Strakosha





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E INSPEKTIMIT DHE MBIKËQYRJES

Nr. 407/prot.

Tiranë, më 19.09.2025

VENDIM

Nr. 35, datë 19.09.2025

PËR

**PËRFUNDIMIN E PROCESIT TË VERIFIKIMIT TË EKZEKUTIMIT TË
VENDIMIT TË KOMISIONERIT NR. 12, DATË 11.04.2025**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, dhe Rregulloren, "Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit", miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, ndryshuar me vendimin nr. 158, datë 30.12.2022, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të relacionit dhe mendimit paraprak të Drejtorit të Përgjithshëm të Inspektimit dhe Mbikëqyrjes dhe Drejtorit të Drejtorisë së Zbatimit të Vendimeve Paralajmëruese dhe Koordinimit, në lidhje me verifikimin e zbatimit të Vendimit nr. 12, datë 11.04.2025, të Komisionerit, "Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes së administrimit të shërbimit civil në institucionin e Bashkisë Përmet dhe paralajmërimit e institucionit për rregullimin e ligjshmërisë, me qëllim përmirësimin e situatës",

KONSTATOVA SE:

Me urdhrin nr. 125, datë 20.12.2024, "Për kryerjen e mbikëqyrjes në lidhje me zbatimin e ligjshmërisë gjatë zhvillimit të procedurave të plotësimit të pozicioneve të lira në shërbimin civil nëpërmjet pranimi në shërbimin civil, lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë, si dhe gjatë aplikimit të institutit të disiplinës në shërbimin civil, në Bashkinë Përmet", Komisioneri ka filluar mbikëqyrjen në lidhje me zbatimin e ligjshmërisë gjatë zhvillimit të procedurave të plotësimit të pozicioneve të lira në shërbimin civil, nëpërmjet pranimi në shërbimin civil; lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë, duke vlerësuar respektimin e kërkesave të ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, nga ana e subjekteve të ngarkuara prej ligjit me detyra specifike për administrimin e këtij procesi në institucionin Bashkia Përmet.

Ky proces është përmbyllur me Vendimin nr. 12, datë 11.04.2025, të Komisionerit, "Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes së ligjshmërisë në administrimin e

Adresa: Rr. "Abdi Toptani", ish-Hotel Drini, Tiranë, Tel: 00355 4268141, Web: www.kmshc.al E-mail: info@kmshc.al

shërbimit civil në njësinë e vetëqeverisjes vendore Bashkia Përmet dhe paralajmërimin e institucionit për rregullimin e ligjshmërisë, me qëllim përmirësimin e situatës”, ku janë lënë detyra konkrete për rregullimin e ligjshmërisë.

Mbështetur në detyrat e lëna në Vendimin nr. 12, datë 11.04.2025 dhe orientimet në raportin përfundimtar të mbikëqyrjes, si dhe referuar informacionit të dërguar nga subjekti, konstatohet se, situata e administrimit të shërbimit civil në institucionin e mbikëqyrur paraqitet si më poshtë vijon:

Në pikën 2, të vendimit paralajmërues, Komisioneri ka kërkuar nga njësia përgjegjëse dhe subjektet e tjera të ngarkuara me detyra të administrimit të shërbimit civil, si komiteti i vlerësimit, analisti i punës dhe eprorët direkt, të përfundojnë klasifikimin racional të pozicioneve të shërbimit civil në kategorinë dhe klasën e zbatueshme për secilën kategori, në përputhje me përcaktimet e nenit 19, të ligjit nr. 152/2023, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, si dhe pikës 5, të vendimit nr. 142, datë 12.3.2014, të Këshillit të Ministrave, duke ndjekur procedurën, sipas orientimeve në përmbajtje të raportit përfundimtar të mbikëqyrjes.

Vërejt se, me Urdhrin nr. 211, datë 23.06.2025, të Sekretarit të Përgjithshëm, është ngritur komiteti i vlerësimit, në kuadër të vlerësimit dhe klasifikimit të pozicioneve të punës në shërbimin civil në Bashkinë Përmet.

Më tej, me shkresën e brendshme nr. 1972 prot., datë 23.06.2025, të Sekretarit të Përgjithshëm, është kërkuar nga të gjitha njësitë drejtuese të institucionit të hartohen përshkrimet e punës për të gjitha pozicionet pjesë e shërbimit civil.

Pas kryerjes së rivlerësimit, konstatohet se, komiteti i vlerësimit ka nxjerrë aktin nr. 1972/1 prot., datë 03.07.2025, drejtuar Kryetarit të Bashkisë Përmet, ku njoftohet përmbyllja e këtij procesi dhe përcaktohet numri total i nëpunësve civilë, si dhe numri i detajuar i nëpunësve civilë për çdo drejtori, bazuar në përshkrimet e punës.

Në pikën 3, të vendimit paralajmërues, Komisioneri ka kërkuar që procesi i vlerësimit dhe klasifikimit të pozicioneve të punës, të pasqyrohet në aktin që shoqëron strukturën e paraqitur për miratim tek Kryetari i Bashkisë, nga njësia përgjegjëse, ose grupi i ngarkuar me këtë detyrë (relacion apo memo) dhe të informohet Komisioneri për vendimmarrjen përfundimtare, duke i dërguar edhe aktin e miratimit të strukturës.

Nga aktet e administruara, rezulton se aktet e prodhuara në kuadër të procesit të rivlerësimit dhe klasifikimit të pozicioneve të punës, të evidentuara më lart, i janë bashkëlidhur draftit të strukturës, e cila është miratuar me Vendimin nr. 269, datë 22.07.2025, të Kryetarit të Bashkisë, “Për disa ndryshime të strukturës organizative”, duke përmbushur kërkesat e pikës 3 të dispozitivit të vendimit paralajmërues.

Në pikën 4, të vendimit objekt i mbikëqyrjes në vazhdim, Komisioneri ka kërkuar që pasi të përcaktohen në mënyrë përfundimtare pozicionet e punës pjesë e shërbimit civil, klasat e zbatueshme për secilën kategori dhe emërtesat e pozicioneve të punës që i përkasin secilës klasë, të rishikohet plani i rekrutimeve në shërbimin civil, duke përfshirë në këtë akt, të gjitha vendet vakante që kanë dalë nga procesi i vlerësimit. Në planin e rekrutimit, në përputhje me strukturën finale të institucionit, të përfshihen pozicionet e punës që janë efektivisht të lira, si dhe pozicionet e plotësuara në kundërshtim me ligjin, me emërim të përkohshëm, duke pasqyruar një planifikim të qartë të rekrutimit, ku të evidentohet përkatësisht, pozicioni i punës dhe afati konkret se kur do të realizohet konkurrimi për plotësimin e tij.

Në dokumentacionin që i është vënë në dispozicion Komisionerit në rrugë elektronike përmes emailit të datës 12.09.2025, vërej se është përcjellë gjithashtu Vendimi nr. 242, datë 01.07.2025, i Kryetarit të Bashkisë, “Për një ndryshim të planit vjetor të pranimeve në shërbimin civil të Bashkisë Përmet”, ku është vendosur numri i rekrutimeve për vendet vakante në shërbimin civil, gjithsej 7 (shtatë) vende vakante të ndara sipas kategorive në listën bashkangjitur këtij vendimi, duke realizuar dhe shpalljet si më poshtë:

1. shpallje nr. 2166 prot., datë 04.07.2025, për plotësimin e pozicionit, “*Specialist Tatim-Taksa*”.
2. shpallje nr. 2166 prot., datë 04.07.2025, për plotësimin e pozicionit, “*Specialist Audit i Brendshëm*”.
3. shpallje nr. 2163 prot., datë 04.07.2025, për plotësimin e pozicionit, “*Specialist Kulture, Arsim Sport*”.
4. shpallje nr. 2164 prot., datë 04.07.2025, për plotësimin e pozicionit, “*Specialist Dhunës në familje*”.
5. shpallje nr. 2165 prot., datë 04.07.2025, për plotësimin e pozicionit, “*Specialist Turizmi*”.
6. shpallje nr. 2168 prot., datë 04.07.2025, për plotësimin e pozicionit, “*Specialist Urbanistike*”.
7. shpallje nr. 2167 prot., datë 04.07.2025, për plotësimin e pozicionit, “*Specialist Strehimi*”.

Referuar emailit të sipërpërmendur, njësia përgjegjëse e institucionit ka informuar se në përfundim të konkurrimit, nga 7 procedura të shpallura, 4 prej tyre kanë përfunduar me kandidatë fitues, ndërsa për 3 procedura nuk është paraqitur asnjë kandidat.

Për sa u parashtrua më sipër, arrij në përfundimin se nga ana e institucionit, Bashkisë Përmet, janë zbatuar detyrat e lëna në Vendimin Paralajmërues Nr.12, datë 11.04.2025, të Komisionerit.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar; ligjin nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” dhe Rregulloren, “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me

Adresa: Rr. “Abdi Toptani”, ish-Hotel Drini, Tiranë, Tel: 00355 4268141, Web: www.kmshc.al E-mail: info@kmshc.al

vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, ndryshuar me vendimin nr. 158, datë 30.12.2022, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

VENDOSA:

1. Përfundimin e procesit të verifikimit të zbatimit të Vendimit nr.12, datë 11.04.2025, të Komisionerit, *“Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes së administrimit të shërbimit civil në institucionin e Bashkisë Përmet dhe paralajmërimin e institucionit për rregullimin e ligjshmërisë, me qëllim përmirësimin e situatës”*”.
2. Konstatimin e rregullimit të situatës së ligjshmërisë nga ana e institucionit të Bashkisë Përmet, në përputhje me detyrimet e Vendimit nr.12, datë 11.04.2025, të Komisionerit.
3. Për këtë vendim të njoftohet institucioni i Bashkisë Përmet
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera Strakosha

